# DËSHMI ARKIVI

**A-446351**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Qytetari lahet në lumin Lana bashkë me minjtë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391831.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 14:27:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 14:21:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 14:20:00 UTC → 15 shtator 2026, 14:22:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `116a86730f3c33db0fc96178f571b57ca65eab3a1a80eba178b8d102965c61ff` |
| TEKSTI | `f3a73879afd9003cf1a1fb2fa5b9cce9b3245e9da8ca8e12612e19775bd25a01` |
| PAMJA | `2a2d5641fe17101df7a2d9f01620f680c735ab2fa9d370905cd5bf99daef43e9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `383e92f4ca6c5c9836ab8bc07e46575dd3f59cb41302a42f979806108a0976ac` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/383e92f4ca6c5c9836ab8bc07e46575dd3f59cb41302a42f979806108a0976ac`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Qytetari lahet në lumin Lana bashkë me minjtë

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 15.09.2026, 16:21

Share Share



Një qytetar është filmuar këtë pasdite duke u larë në lumin Lana, pavarësisht temperaturave që janë ulur ndjeshëm gjatë ditëve të fundit.

Mesa duket, vapa ka qenë e mjaftueshme për ta shtyrë atë të hyjë në ujërat e Lanës për t'u freskuar.

Por qytetari nuk ishte i vetëm në lumë. Pak metra më tutje, në ujë janë futur me shpejtësi edhe një tufë minjsh.

Në pamjet e filmuara, shihet grupi i minjve që lëviz drejt lumit dhe futet në ujë, ndërsa qytetari vijon të lahet vetëm pak metra larg tyre.

Pamjet ngrejnë edhe një herë pikëpyetjet për rrezikun që paraqet kontakti me ujin e Lanës, i cili është i ndotur dhe nuk konsiderohet i përshtatshëm për larje apo kontakt të drejtpërdrejtë me trupin.

Ujërat e ndotura mund të përmbajnë baktere dhe mikroorganizma që mund të shkaktojnë infeksione dhe probleme shëndetësore, veçanërisht në rast të kontaktit me plagë apo gëlltitjes së ujit.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.